

# REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

SFIDAT DHE QASJET LIGJORE NË  
LUFTËN KUNDËR SHFRYTËZIMIT DHE  
ABUZIMIT SEKSUAL ONLINE TË TË  
MITURVE NË SHQIPËRI

Entela HASMUJAJ  
Albulena KULIÇI



Financuar nga  
Bashkimi Evropian





---

**PUBLIKUES**

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3.

Tel: +355 44 104 247

E-mail: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)Web: [www.em-al.org](http://www.em-al.org)**AUTORË**

Entela HASMUJAJ

Albulena KULIÇI

dhjetor 2025

**VITI I PUBLIKIMIT**

---

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



---

Hyrje	03
Konventat ndërkombëtare dhe angazhimi i Shqipërisë për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual online	04
Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë për krimet seksuale ndaj fëmijëve	04
Rreziku i shfytëzimit online për fëmijët në Shqipëri: "grooming", "CSAM" dhe sfidat e zbatimit	06
Problematika të praktikës së punës të organeve të ndjekjes penale	08
Përfundime	10
Rekomandime	11
REFERENCA	12

---

Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual i fëmijëve përbëjnë ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut, me pasoja të thella psikologjike, sociale dhe zhvillimore për të miturit. Në dekadat e fundit, shtrirja e internetit dhe përdorimi masiv i platformave dixhitale kanë transformuar mënyrën se si fëmijët komunikojnë, mësojnë dhe argëtohen, por njëkohësisht kanë krijuar edhe hapësira të reja rreziku. Mjedisi online u jep abuzuesve mundësi më të lehta kontakti me fëmijët, i lejon të veprojnë me anonimitet dhe shpesh e bën më të vështirë identifikimin e tyre, ndërkohë që përmbajtjet e dëmshme mund të shpërndahen me shpejtësi dhe të mbeten në qarkullim për një kohë të gjatë.

Në këtë kontekst, abuzimi seksual online nuk kufizohet vetëm te publikimi i materialeve me përmbajtje seksuale që përfshijnë fëmijë, por shfaqet edhe në forma të tjera si manipulimi seksual, ngacmimi seksual në rrjete, shantazhi seksual, kërkesat për dërgim fotosh/mesazhesh intime, apo nxitja e takimeve me qëllime shfrytëzimi. Këto forma shpesh ndërthuren me njëra-tjetrën dhe mund të fillojnë si komunikim “i padëmshëm”, por të kalojnë gradualisht në kontroll, presion emocional dhe shfrytëzim. Për këtë arsye, mbrojtja e të miturve në mjedisin digjital kërkon jo vetëm ndërgjegjësim dhe parandalim, por edhe mekanizma të fortë ligjorë, institucionalë dhe teknikë.

Shqipëria, si shumë vende të tjera, është përballur me nevojën për të përshtatur qasjen e saj ndaj këtij fenomeni, duke kombinuar standardet ndërkombëtare me legjislacionin e brendshëm dhe kapacitetet e zbatimit. Ndërsa, kuadri ligjor synon të garantojë dënueshmërinë

e veprave dhe mbrojtjen e viktimave, sfida reale shfaqet në mënyrën se si këto norma përkthehen në hetim efektiv, mbledhje të provave dixhitale, identifikimin e autorëve dhe shmangien e riviktimizimit. Kjo e bën luftën kundër abuzimit seksual online një çështje që nuk zgjidhet vetëm me dispozita penale, por kërkon bashkëpunim ndërinstitucional, kapacitete të specializuara dhe koordinim ndërkufitar.

Ky artikull trajton pikërisht këto dimensione: si ndërtohet kuadri mbrojtës për të miturit përballë abuzimit online, si funksionon ndëshkimi penal në teori, edhe pse në praktikë shumë raste hasin vështirësi në finalizim. Duke e parë fenomenin si një problem njëkohësisht ligjor, teknik dhe shoqëror, analiza synon të nxjerrë në pah pikat ku sistemi funksionon dhe pikat ku kërkohej përmirësime, me qëllim rritjen e sigurisë së fëmijëve në hapësirën dixhitale.

## Konventat ndërkombëtare dhe angazhimi i Shqipërisë për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual online

Konventa e Lanzarotës (CETS 201), e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2009, është instrumenti kryesor i Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve, duke përfshirë edhe format online. Ajo kërkon masa parandaluese si edukimi i fëmijëve për rreziqet (Neni 6) dhe trajnimi i profesionistëve që punojnë me fëmijët (Neni 5), si edhe mekanizma mbështetës për viktimat (Nenet 12-14) [1]. Në planin penal, konventa u kërkon shteteve të kriminalizojnë veprimet që lidhen me materialet e abuzimit seksual të fëmijëve “child pornography” (Neni 20) dhe “grooming”-un si propozim për takim për qëllime seksuale përmes teknologjisë (Neni 23), ndërsa thekson edhe rregullat e juridiksionit dhe nevojën për bashkëpunim kur veprat lidhen me dimensionin ndërkufitar (Nenet 24-25) [2].

Konventa e Stambollit (CETS 210) është instrumenti kryesor i Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftënkundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, por është relevante edhe për mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht kur ata janë viktimat ose dëshmitarë të dhunës. Ajo përcakton se “gratë” përfshijnë edhe vajzat nën 18 vjeç (Neni 3) dhe i vendos shtetit detyrimin e kujdesit të posaçëm për të parandaluar, hetuar, ndëshkuar dhe siguruar mbrojtje/riparim për aktet e dhunës, edhe kur kryhen nga persona private (Neni 5). Konventa kërkon mbështetje të posaçme për fëmijët dëshmitarë të dhunës (Neni 26), sanksionimin e ngacmimit seksual (Neni 40) dhe e koncepton

dhunën seksuale mbi mungesën e pëlqimit (Neni 36), standard që ndihmon edhe në trajtimin e formave të dhunës me natyrë seksuale që shfaqen në mjediset online [3].

Konventa e Budapestit (CETS 185) është instrumenti kryesor për luftën kundër krimeve kibernetike dhe përforcon bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimet dixhitale, çka është vendimtare kur abuzimi seksual ndaj fëmijëve ndodh online dhe provat/autorët mund të jenë jashtë vendit. Ajo kërkon kriminalizimin e veprave që lidhen me “pornografinë me fëmijë” (Neni 9), ndërsa në aspektin procedural parashikon mjete konkrete për hetim efektiv: ruajtje të përsheptuar të të dhënave për të mos humbur provat (Neni 16), ruajtje / zbulim të të dhënave të trafikut (Neni 17), urdhër-prodhimin për marrjen e të dhënave dhe informacioneve të abonentit nga ofruesit e shërbimeve (Neni 18), si edhe rrjetin 24/7 të pikave të kontaktit për asistencë të menjëhershme në rastet ndërkufitare (Neni 35) [4].

## Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë për krimet seksuale ndaj fëmijëve

Në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 me titull “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në seksionin VI, me titull “Krimet seksuale” përfshin disa nene specifike lidhur me krimet seksuale ndaj të miturve dhe sanksionon masa të larta dënimi për autorët e këtyre veprave. Sidoqoftë, zbatimi i këtyre neneve në praktikë ka ndeshur në disa vështirësi, veçanërisht për shkak të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë dhe rritjes së përdorimit të internetit për kryerjen e këtyre krimeve.

Neni 100 i Kodit Penal synon të mbrojë fëmijët nën 14 vjeç (si edhe të miturit që “nuk kanë arritur pjekurinë seksuale”) nga çdo formë marrëdhënieje seksuale [5]. Kjo dispozitë funksionon si ndalim “absolut”: nëse kryhet marrëdhënie seksuale me një fëmijë nën 14 vjeç, vepra konsiderohet e kryer pavarësisht nëse i mituri shprehet “dakord”, sepse ligji e trajton këtë moshë si të paaftë për pëlqim të vlefshëm [6]. Parashikohen dënime të larta, të cilat rriten kur vepra kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, me dhunë, ose kur i shkaktohen fëmijës pasoja të rënda shëndetësore; ndërsa në rastet kur vepra sjell vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës, dënimi arrin deri në burgim shumë të rëndë, përfshirë burgimin e përjetshëm [7].

Neni 101 i Kodit Penal trajton një situatë tjetër: marrëdhëniet seksuale me të mitur të moshës 14-18 vjeç (që kanë arritur pjekurinë seksuale), por vetëm kur ato kryhen “me dhunë”. Këtu elementi thelbësor është përdorimi i dhunës: ligji ndëshkon faktin që akti seksual imponohet, duke cenuar lirinë dhe integritetin seksual të të miturit [8]. Dënimet ashpërsohen kur vepra kryhet në bashkëpunim, përsëritet ose sjell pasoja të rënda shëndetësore, dhe rriten edhe më tej kur vepra sjell vdekjen ose vetëvrasjen e të miturit [9].

Neni 117 i Kodit Penal është dispozita më e lidhur drejtpërdrejt me dimensionin online të shfrytëzimit/ abuzimit seksual, sepse rregullon pornografinë dhe, në mënyrë të veçantë, “pornografinë e fëmijëve”. Fillimisht, ky nen sanksionon si kundërvajtje prodhimin, shpërndarjen, reklamimin, importimin, shitjen ose botimin e materialeve pornografike në mjedise ku ka fëmijë, duke synuar të

parandalojë ekspozimin e tyre ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme [10].

Më tej, në paragrafin 2 të këtij neni, parashikohet dënim shumë më i ashpër penal për “pornografinë e fëmijëve”, duke kriminalizuar jo vetëm prodhimin dhe shpërndarjen, por edhe importimin, ofrimin, vënien në dispozicion, transmetimin, përdorimin, posedimin, si edhe krijimin e aksesit “në mënyrë të vetëdijshme” në të, me çdo mjet ose formë. Kjo pjesë është thelbësore për rastet online, sepse përfshin sjellje tipike të internetit si shpërndarja në platforma, shkarkimi dhe ruajtja, ose hapja e materialeve me qëllim [11].

Në fund, neni 117 në paragrafin 3, sanksionon me dënime të larta për autorët e këtyre veprave që rekrutojnë, përdorin, shtrëngojnë ose bindin një fëmijë për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, si dhe pjesëmarrjen në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët [12]. Kjo mbulon forma të shfrytëzimit ku i mituri vihet të kryejë veprime seksuale përpara kamerës apo në transmetime “live”, duke e lidhur dispozitën jo vetëm me përmbajtjen e regjistruar, por edhe me format e reja të shfrytëzimit të ndërmjetësuar nga teknologjia.

Neni 108 i Kodit Penal, me titull “Vepra të turpshme” sanksionon ndëshkueshmërinë e veprimeve me natyrë seksuale ndaj të miturve nën 14 vjeç, duke synuar të mbulojë forma të abuzimit seksual që nuk arrijnë domosdoshmërisht në marrëdhënie seksuale, por cenojnë integritetin dhe dinjitetin e fëmijës. Dispozita parashikon dënim më të lartë kur vepra kryhet ndaj një të mituri nën 14 vjeç me të

cilin autori ka marrëdhënie familjare, duke e konsideruar këtë një rrethanë rënduese [13].

Me ndryshimet që pësoi me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, neni 108 i Kodit Penal, u përafua më shumë me standardet ndërkombëtare, duke kriminalizuar edhe përfshirjen e qëllimshme të të miturit si dëshmitar në veprime me natyrë seksuale (si për fëmijët nën 14 vjeç, ashtu edhe për të miturit që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale), si dhe duke sanksionuar “propozimin” nga një i rritur për të takuar një të mitur për qëllime seksuale [14]. Ky element që lidhet drejtpërdrejt me fenomenin e abuzimit të ndërmjetësuar nga komunikimi online.

Neni 108/a i Kodit Penal, me titull “Ngacmimi seksual” kriminalizon sjellje me natyrë seksuale që cenojnë dinjitetin e personit dhe krijojnë një mjedis kërcënues, armiqtësor, degradues, poshtërues ose ofendues [15], duke qenë i aplikueshëm edhe kur këto sjellje ndodhin përmes mjeteve të komunikimit elektronik. Dënimi ashpërsohet në rrethana cilësuese, kur vepra kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kur viktimat janë fëmijë [16], çka e bën këtë dispozitë veçanërisht të rëndësishme për trajtimin penal të formave të ngacmimit seksual online (p.sh. mesazhe të përsëritura, kërkesa seksuale, dërgim i përmbajtjeve eksplicite).

## Rreziku i shfrytëzimit online për fëmijët në Shqipëri: “grooming”, “CSAM” dhe sfidat e zbatimit

---

Rritja e përdorimit të internetit nga fëmijët në

Shqipëri krijon një terren ku rreziku i shfrytëzimit dhe abuzimit seksual online bëhet më i prekshëm dhe më i vështirë për t'u kontrolluar. Studimi i World Vision (2014) evidenton se fëmijët hyjnë në internet kryesisht përmes aparateve telefonike (rreth 65%) dhe kompjuterit/ laptopit (rreth 59%), duke e bërë kontaktin me rrjetet sociale dhe përmbajtje të pakontrolluara shumë më të shpeshtë [17]. Në të njëjtën linjë, raportohen ekspozime shqetësuese ndaj përmbajtjeve pornografike (p.sh., 44% e fëmijëve deklarojnë se shohin materiale pornografike çdo ditë), si dhe dobësi të masave mbrojtëse në mjedise jashtë shtëpisë: ndërsa rreth 74% e kompjuterëve familjarë kanë aplikacione sigurie, në shkolla dhe internet-kafe kjo bie në rreth 16% [18]. Sondazhi tregon se 45% e fëmijëve (13-18 vjeç) përjetojnë çdo ditë bullizëm, vjedhje fjalëkalimesh dhe ekspozim të pavullnetshëm ndaj pornografisë; ndërsa 47% janë kontaktuar online nga të rritur të panjohur. Këto të dhëna e lidhin drejtpërdrejt rrezikun me “hapësirat e pambikëqyrura” ku fëmijët lundrojnë në internet dhe shpjegojnë pse parandalimi nuk mund të mbështetet vetëm te familja, por kërkon politika të integruara sigurie në shkollë dhe komunitet.

Brenda kësaj panorame, ‘grooming-u’ seksual shfaqet si një nga format më tipike dhe më të rrezikshme të kontaktit abuziv online, sepse ndërtohet si proces dhe jo si ngjarje e vetme. Veleshnja dhe Hoxha (2024) e përshkruajnë grooming-un si sjellje predatore (zakonisht i rrituri ndaj të miturit) që zhvillohet në kohë, me synim krijimin e lidhjes/besimit për të mundësuar abuzimin seksual [19]. Prosesi paraqitet me faza të dallueshme: përzgjedhja e viktimës, izolimi, ndërtimi i besimit/ afërsisë, përgatitja mendore/ fizike për akte seksuale

dhe ruajtja e marrëdhënies/ kontrollit [20]. Autorët theksojnë se mjedisi online e lehtëson këtë sjellje për shkak të anonimitetit dhe komunikimeve pa mbikëqyrje, ku platforma me kontrole të dobëta (p.sh. 'chatrooms') e rrisin ekspozimin e të miturve ndaj kontaktit me të panjohur [21].

Në kuadrin ligjor shqiptar, problematike është mënyra e ndërtimit të normës penale, si dhe te boshllëqet për format moderne dixhitale të dhunës seksuale. Kullaj (2025) vëren se terminologjia në Kodin Penal ka elemente të vjetruara dhe diskuton kritikisht faktin që disa dispozita mbështeten ende tek "forca" si element përbërës, ndërsa modelet bashkëkohore europiane anojnë drejt qasjes së bazuar te "mungesa e pëlqimit" [22]. Për fëmijët, Kullaj problematizon nenin 108 ("vepra të turpshme") si term i paqartë dhe i vjetër, për të cilin gjykatat / organet e ndjekjes penale e kanë mbushur këtë boshllëk duke e përdorur nenin 108 për sjellje si: prekja seksuale e fëmijës dhe ekspozimi i organeve gjenitale para fëmijës, duke u bazuar në praktikë, jo nga qartësia e nenit vetë [23].

Por nga ana tjetër sipas autorit vihet në dukje se përafrimi me standardet europiane (përfshirë qasjen e Konventës së Lanzarotës) ka sjellë përmirësime me ndryshimet e vitit 2013, duke shtuar paragrafe që kriminalizojnë si përfshirjen e qëllimshme të të miturit si dëshmitar në veprime me natyrë seksuale, ashtu edhe "propozimin" për takim për qëllime seksuale (solicitation/ grooming), me një formulim të afërt me standardet ndërkombëtare [24].

Paralelisht, theksohet se realiteti dixhital po prodhon forma abuzimi që kërkojnë normim

më të përditësuar dhe më koherent, për shpërndarjen pa pëlqim të imazheve intime dhe për shantazhin seksual (sextortion) bën që këto fenomene të trajtohen shpesh përmes dispozitave të tjera anësore dhe se këto trajtohen shpesh me nene të tjera, duke sjellë paqartësi dhe mungesë koherence në hetim [25].

Edhe instrumente administrative, siç është regjistri i të dënuarve për krime seksuale, miratuar me ligjin nr. 62/2022, ka problematikat e veta kur kategorizimi i veprave nuk reflekton plotësisht format e shfrytëzimit seksual / pornografisë me fëmijë, duke rrezikuar që disa dënime të mos pasqyrohen siç duhet [26]. Në këtë kuptim, sfida nuk është vetëm ekzistenca e marzheve të lartë të dënimit për krimet seksuale ndaj fëmijëve, por edhe normimi i saktë i këtyre veprave dhe përditësimi i instrumenteve juridike për t'iu përgjigjur dinamikave të abuzimit online.

Dimensioni i "pornografisë me fëmijë"/CSAM (Child Sexual Abuse Material - Material i Abuzimit Seksual ndaj Fëmijëve) dhe hendeku institucional dalin shumë të theksuar te analizat e Dedja-s. Autorja përmend se në 2018 domain-i ".al" u rendit shumë lart për hostim të materialeve të abuzimit seksual të fëmijëve dhe se mijëra sinjalizime / raste të referuara ndërkombëtare i janë referuar Shqipërisë për prodhim / përdorim të CSAM, ndërkohë që numri i rasteve të hetuara dhe i identifikimeve të autorëve ka qenë jashtëzakonisht i ulët në raport me shkallën e problematikës [27].

Dedja sqaron pse termi "CSAM" është më i përshtatshëm se "child pornography" (pornografi me fëmijë/pornografi e fëmijëve),

sepse thekson natyrën abuzive/shfrytëzuese të përmbajtjes [28]. Nga ana procedurale, ajo përshkruan zinxhirin hetimor: autorizime, urdhra gjyqësorë për të dhënat nga ISP (Internet Service Provider - Ofrues i Shërbimit të Internetit), ekspertim kompjuterik/audioviziv, vlerësime për natyrën e imazheve dhe përcaktim të moshës së të miturit, një proces që kërkon ekspertizë dixhitale të specializuar dhe shpesh bashkëpunim ndërkombëtar në rastet ndërkufitare [29].

Dedja argumenton se një hap i rëndësishëm për forcimin e reagimit institucional në Shqipëri do të ishte krijimi i një nën-njësie të specializuar për CSAM brenda Njesisë së Krimeve Kibernetike, duke u frymëzuar nga modeli britanik (CEOP - Child Exploitation and Online Protection Command), i cili funksionon si strukturë e dedikuar për raportimin dhe hetimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve online [30]. Një njësi e tillë do të përqendrohej te identifikimi dhe shpëtimi i viktimave, gjurmimi i personave të përfshirë në prodhimin / shpërndarjen e materialeve abuzive dhe zhvillimi i metodave hetimore dixhitale [31].

## Problematika të praktikës së punës të organeve të ndjekjes penale

Gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, sfida kryesore për rastet e shfrytëzimit / abuzimit seksual online ndaj të miturve nuk qëndron domosdoshmërisht tek mungesa e qartësisë së dispozitave në Kodin Penal, por tek aftësia për të shkuar te autori përmes provës elektronike.

Identifikimi i autorit është i vështirë në shumë raste, për shkak të mungesës së mjeteve dhe kapaciteteve për kërkimin, ruajtjen dhe analizimin e provave dixhitale, tipike për krimet kibernetike. Edhe kur hetimi arrin të nxjerrë një gjurmë teknike (p.sh. IP), kjo nuk e zgjidh automatikisht çështjen: IP-ja mund të jetë e lidhur me servera jashtë Shqipërisë ose me regjistrime që nuk të çojnë lehtë te personi real pas llogarisë.

Një pjesë e madhe e vështirësive lidhet me dimensionin ndërkufitar dhe varësinë nga kompani / platforma private. Kur IP-ja ose të dhënat e llogarisë lidhen me një shtet tjetër, prokuroria duhet të kërkojë informacion përmes letër-porosive; por shtetet kanë rregullime të ndryshme dhe shumë prej tyre kërkojnë vendim gjyqësor për dhënien e të dhënave kompjuterike. Kjo bëhet edhe më komplekse kur të dhënat kërkohen nga platforma si Facebook, Instagram, Snapchat, WhatsApp, ku rruga procedurale përfshin: marrjen e vendimit të gjykatës, dërgimin e kërkesës te kompania dhe pritjen e përgjigjeve, ndërkohë që vetë gjurmimi mbetet i vështirë sepse llogaritë mund të hapen me e-mail të pavlefshëm, pa të dhëna reale identifikuese, ose me skema anonimizimi.

Edhe kur vjen një përgjigje dhe arrihet të identifikohet “kush e kishte IP-në”, sukcesi i hetimit nuk është i garantuar. Praktika tregon raste kur IP del e lidhur me një zonë të caktuar, por në fakt përdoret nga Wi-Fi publik (lokale, mjedise ku futesh dhe përdor rrjetin), duke e vështirësuar lidhjen personale autor-vepër. Kjo e kthen provën dixhitale në provë që kërkon verifikim të shumëfishtë (kohë, vend, pajisje,

përdorues), dhe shpesh e ul mundësinë e finalizimit të çështjes me autor të identifikuar dhe akuzë të njoftuar.

Një tjetër problem specifik për pornografinë online apo materialet e abuzimit seksual ndaj fëmijëve është vetë materiali dhe shpërndarja e tij pas publikimit: edhe në rast se autori ndëshkohet, viktima rrezikon riviktimizim sepse është praktikisht e pamundur të garantohet fshirja e përmbytjes nga çdo pajisje apo kopje e shpërndarë. Materialet mund të jenë shkarkuar, rishpërndarë dhe ruajtur nga përdorues të paignifikueshëm, duke e bërë dëmin afatgjatë dhe kontrollin total të pamundur. Për këto raste vjen në ndihmë Qendra Kombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar (NCMEC), me qendër në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila merr sinjale dhe të dhëna kur në rrjete sociale qarkullon material i dyshimtë, çka ndihmon në verifikime të shpejta dhe identifikim kur të dhënat janë të sakta; por edhe ky mekanizëm nuk e zgjidh problemin kur identitetet fshihen pas regjistrimeve të rreme ose rrjeteve publike.

Nga trajtimi i kuadrit ligjor ndërkombëtar, legjislacionit kombëtar, si dhe të dhënave të nxjerra nga literatura juridike dhe problematika të evidentuara në praktikë, del se mbrojtja e të miturve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual online nuk është më një çështje dytësore, por një rrezik i përditshëm që rritet paralelisht me përdorimin masiv të internetit nga fëmijët. Forma si: manipulimi seksual, shpërndarja e materialeve abuzive, shantazhi seksual dhe ngacmimi në rrjete krijojnë një realitet ku abuzimi shpesh fillon si komunikim i zakonshëm dhe përshkallëzohet gradualisht, duke e bërë të vështirë zbulimin e hershëm dhe ndërhyrjen në kohë.

Po ashtu, edhe kur baza ligjore për dënueshmërinë e këtyre veprave ekziston, sfida kryesore shfaqet te zbatimi praktik: hetimi i krimeve online varet nga prova elektronike, nga ruajtja e shpejtë e të dhënave dhe nga aftësia për të gjurmuar autorin përtej identifikimit fillestar teknik. Në shumë raste, gjurmët dixhitale të çojnë te IP të lidhura me servera jashtë vendit, te llogari të hapura me të dhëna të rreme, ose te rrjete publike (p.sh. Wi-Fi në mjedis të hapur), gjë që e vështirëson lidhjen e qartë autor-vepër dhe ul mundësinë e finalizimit të procedimeve me identifikim real të personit përgjegjës.

Një element i veçantë që e rëndon fenomenin është natyra e materialeve abuzive online: edhe kur arrihet sukses në ndëshkim penal, përmbajtja mund të ketë kaluar në shumë pajisje, të jetë shkarkuar dhe rishpërndarë, duke e bërë të pamundur fshirjen totale dhe rrit rrezikun e riviktimizimit afatgjatë të fëmijës. Kjo tregon se përgjigja efektive nuk mund të jetë

vetëm ndëshkuese; ajo duhet të jetë njëkohësisht parandaluese, hetimore-teknike dhe mbrojtëse për viktimat, me qëllim që të minimizohet dëmi dhe të ndërpritet përhapja e përmbajtjes.

Prioritet në mbrojtjen e të miturve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual online duhet të jetë forcimi i aftësive reale hetimore për provën elektronike: nevojiten mjete moderne të forenzikës dixhitale, protokolle të standardizuara për ruajtjen urgjente të të dhënave dhe një ritëm më i shpejtë procedurash që të shmangët humbja e provës. Krahas kësaj, duhet rritur specializimi institucional dhe koordinimi mes aktorëve përgjegjës, në mënyrë që rastet të trajtohen me ekspertizë të përqendruar dhe jo si pjesë e përgjithshme e kriminalitetit, sepse krimet seksuale online ndaj të miturve kanë logjikë dhe prova specifike.

Një tjetër drejtim thelbësor është përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe i komunikimit me platformat dixhitale, duke bërë sa më funksionale kërkesat për të dhëna dhe duke shmangur vonesat që e bëjnë të pamundur gjurmimin. Kur të dhënat janë jashtë vendit, vonesa procedurale shpesh barazohet me humbje prove; ndaj kërkohen rrugë më efikase, kontakte operative dhe standardizim kërkesash, që identifikimi të mos mbetet vetëm në nivel IP-je, por të shkojë deri te personi real.

Parandalimi duhet të trajtohet si shtyllë po aq e rëndësishme sa ndjekja penale. Kjo nënkupton edukim të vazhdueshëm në shkolla për sigurinë online, rritje të aftësisë së prindërve dhe mësuesve për të dalluar shenjat e manipulimit seksual, si dhe krijim të mekanizmave të raportimit miqësor për fëmijët. Paralelisht, duhet garantuar mbështetje psikologjike dhe mbrojtje e mirëfilltë për viktimat, me masa që minimizojnë riviktimizimin gjatë procedimit dhe që synojnë, sa të jetë e mundur, kufizimin e përhapjes së materialit abuziv në internet.

- [1] Council of Europe. Council of Europe Convention on the Protection of Children against Sexual Exploitation and Sexual Abuse (Lanzarote, 25 October 2007). Council of Europe Treaty Series - No. 201. <https://rm.coe.int/1680084822>
- [2] Po aty.
- [3] Council of Europe. Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul, 11 May 2011). Council of Europe Treaty Series. <https://rm.coe.int/168008482e>
- [4] Council of Europe. Convention on Cybercrime (Budapest, 23 November 2001). Council of Europe Treaty Series. <https://rm.coe.int/1680081561>.
- [5] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 (i ndryshuar), neni 100 "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur", Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Dhjetor 2014, f. 36.
- [6] Po aty.
- [7] Po aty.
- [8] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 (i ndryshuar), neni 101 "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç", Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Dhjetor 2014, f. 36.
- [9] Po aty.
- [10] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 (i ndryshuar), neni 117 "Pornografia", Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Dhjetor 2014, f. 42-43.
- [11] Po aty.
- [12] Po aty.
- [13] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 (i ndryshuar), neni 108 "Vepra të turpshme", Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Dhjetor 2014, f. 38.
- [14] Po aty.
- [15] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 (i ndryshuar), neni 108/a "Ngacmimi seksual", Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Dhjetor 2014, f. 38.
- [16] Po aty.
- [17] World Vision Albania. A Study on Child Online Safety in Albania. Tirana: World Vision, 2014. f. 9.
- [18] World Vision Albania. A Study on Child Online Safety in Albania. Tirana: World Vision, 2014. f. 17.
- [19] Veleshnja, Ina, and Dorina Hoxha. "Analyzing online sexual grooming of minors and the case of the albanian criminal framework." *Academic Journal of Interdisciplinary Studies* 13, no. 1 (2024): 160.
- [20] Po aty.
- [21] Po aty.
- [22] Kullaj, Maend. "Wording Matters. Reconceptualizing Sexual Violence through Contemporary Legal Terminology." *Academicus International Scientific Journal* 16, no. 32 (2025): 150-164.
- [23] Po aty.
- [24] Po aty.
- [25] Po aty.
- [26] Po aty.
- [27] Dedja, Ilvana. Uncovering darkness: Child sexual abuse material online in Albania. n.d. aksesuar më 16 dhjetor 2025.

[[https://www.dcaf.ch/sites/default/files/imce/ECA/Ilv\\_anaDedja\\_Young-faces2023.pdf](https://www.dcaf.ch/sites/default/files/imce/ECA/Ilv_anaDedja_Young-faces2023.pdf)].

[28] Po aty.

[29] Po aty.

[30] Po aty.

[31] Po aty.